



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT

Nr. 815 Prot

Tiranë, më 09 . 11 . 2024

Lënda:

PLAN VEPRIMI

lidhur me verifikimin në subjekt të ecurisë së procesit të zbatimit të ligjit gjatë aplikimit të skemës së administrimit të shërbimit civil në administratën vendore dhe asistencën e këtyre institucioneve për të kuptuar dhe zbatuar drejt udhëzuesin e Komisionerit në lidhje me këtë aspekt.

*Drejtorisë së Përgjithëshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes
Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
Këtu*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të kompetencës ligjore për mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil, përcaktuar në nenet 11, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ka ushtruar në vazhdimësi procesin e mbikëqyrjes për institucionet që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, duke përfshirë edhe institucionet e qeverisjes vendore, sipas planit të punës të miratuar për çdo vit.

Komisioneri është kujdesur që të qëndrojë pranë këtyre institucioneve, duke i ofruar asistencë teknike të vazhdueshme, e cila ndër vite është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit me personat e kontaktit të autorizuar prej tyre, me qëllim që të parandalohen shkeljet ligjore, si dhe të sigurohet një administrim sa më efikas i shërbimit civil.

Për këtë arsye, në kuadër të veprimeve konkrete që janë duke u ndërmarrë nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të Vendimit nr. 9, datë 30.01.2024, "Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin

2024 dhe ngritjen e grupit të punës që do të mbikëqyrë këtë proces”, me qëllim për t’iu ardhur në ndihmë institucioneve të administratës vendore, lidhur me standardizimin e strukturës organizative në zbatim të akteve nënligjore, Komisioneri, me shkresën nr. 654 prot., datë 02.10.2024, ka dërguar pranë institucioneve të vetëqeverisjes vendore, udhëzimin përkatës, “*Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në strukturën organizative të institucioneve të administratës vendore dhe transferimin e nëpunësve civil për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, i cili orienton njësitë përgjegjëse lidhur me aplikimin e këtyre procedurave në institucionet e njësisve të vetëqeverisjes vendore.

Ky proces është duke u zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), duke koordinuar veprimet administrative si dhe hapat që duhet të ndiqen në vazhdim dhe është materializuar me shkresat përkatëse të të dy institucioneve.

Në këtë kuadër u planifikuan dhe u realizuan në Selinë e Komisionerit tre takime pune, ku morën pjesë 61 bashkitë e vendit në të cilat morën pjesë edhe përfaqësuesit e AMVV-së, në datat 22-24 Tetor 2024.

Në këto takime morën pjesë sekretarët e përgjithshëm dhe njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucioneve përkatëse dhe diskutimi u fokusua drejt rëndësisë së zbatimit të akteve nënligjore që përcaktojnë strukturën e shërbimit civil dhe kategoritë përkatëse në NJQVV. Në përfundim të këtyre takimeve u konkludua se zbatimi në praktikë i proceseve të cilat kanë të bëjnë me hartimin dhe përgatitjen e strukturave organizative është një nga sfidat më të mëdha të këtij procesi, në këtë tipologji institucionesh dhe u sollën në vëmendje disa momente kyçe që kërkojnë kujdes të veçantë nga aktorët e ngarkuar prej ligjit me detyra specifike, ndër të cilat:

1. Vlerësimi i pozicioneve të punës, i cili duhet të finalizohet me një listë përfundimtare të pozicioneve që përfshihen në shërbimin civil në institucion.
2. Trajtimi i punonjësve të institucionit, në rastet kur marrëdhënia e tyre e punësimit mund të preket nga proceset e rivlerësimit dhe ristrukturimit, duke u siguruar që të kenë dëmshpërblim sipas vjetërsisë në punë në rastet e lirimit për të dyja rrethanat.
3. Zgjidhja e problemeve ligjore që kanë të bëjnë me rastet e punonjësve të emëruar në kundërshtim me ligjin në momentin e zhvillimit të këtyre proceseve, të cilët nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civilë, e për pasojë nuk mund të sistemohen në pozicione të shërbimit civil pas procesit të ristrukturimit apo rivlerësimit.

Nisur nga analiza e këtyre proceseve dhe vështirësitë në implementimin e manualeve orjentuese për strukturimin e institucioneve të shfaqura nëpërmjet pyetjeve dhe problematikat e relatuar nga pjesëmarrësit në këto takime apo gjatë komunikimeve të vazhdueshme me njësitë e qeverisjes

vendore, Komisioneri vlerëson se, për ecurinë normale të fazave në të cilat ndodhen proceset e riorganizimit të burimeve njerëzore; në zbatim të vendimit nr. 9, datë 30.01.2024, të Komisionerit, “Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2024 dhe ngritjen e grupit të punës që do të mbikëqyrë këtë proces” si dhe të vendimit nr.17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, “Për miratimin e rregullores Mbi procedurat e Mbikëqyrjes/inspektimit”, të ndryshuar, veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, përgjatë dy muajve në vijim duhet të orientohet dhe fokusohet në realizimin e këtij objekti, nëpërmjet takimeve të punës në subjekt dhe dhënies së asistencës tekniko - profesionale, për të finalizuar procesin e standartizimit në strukturat organizative të NJQVV, për vitin 2025, duke synuar përmbushjen me sukses të kësaj sfide të vështirë që haset sot në këto institucione.

Nisur nga sa më sipër, realizimi i këtij procesi do të kryhet sipas planit të veprimit për aktivitetet në subjektet e qeverisjes vendore për periudhën nëntor-dhjetor, 2024, sipas grafikut në vijim dhe autorizimeve që do dalin gjatë këtij procesi.

Tabela nr.1: Grafiku për realizimin e planit të veprimit

INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS VENDORE	GRUPI I PUNËS	PERIUDHA E VERIFIKIMIT
Qarku Fier (B. Fier, B. Lushnje, B. Divjakë, B. Mallakastër, B. Patos, B. Roskovec) (Automjeti i punës)	A. Basha A. Xhaxhiu A. Kabali F. Doksani	04.11.2024 - 15.11.2024
Qarku Elbasan (B. Elbasan, B. Belsh, B. Cërrik, B. Peqin, B. Librazhd, B. Prrenjas) (Transport publik)	A. Shumeli L. Zhupa B. Hoxha E. Mata E. Qerimaj	04.11.2024 - 15.11.2024
Qarku Korçë (B. Korçë, B. Pogradec, B. Maliq, B. Kolonjë, B. Devoll, B. Pustec) (Transport publik)	L. Zhapa Z. Mujali E. Hoxha I. Skënderi	04.11.2024 - 15.11.2024
Qarku Berat (B. Berat, B. Kuçovë, B. Dimal, B. Skrapar, B. Polican) (Transport publik)	E. Hebibasi I. Çani S. Ndoka H. Peti B. Zyli	04.11.2024 - 15.11.2024

Qarku Lezhë (B. Lezhë, B. Kurbin, B. Mirditë) (Automjeti i punës)	A. Basha A. Xhaxhiu A. Kabali F. Doksani	18.11.2024 - 21.11.2024
Qarku Shkodër (B. Shkodër, B. Malësi e Madhe, B. Vau Dejës, B. Pukë, B. Fushë Arrëz) (Transport publik)	E. Hebibasi D. Halilaj S. Ndoka H. Peti B. Zyli	18.11.2024 - 21.11.2024 02.12.2024 – 06.12.2024 10.12.2024 – 13.12.2024
Qarku Kukës dhe Qarku Dibër (B. Kukës, B. Has, B. Tropojë, B. Bulqizë, B. Dibër, B. Mat, B. Klos) (Transport publik)	L. Zhapa L. Zhupa I. Çani E. Hoxha I. Skënderi	18.11.2024 - 21.11.2024 02.12.2024-13.12.2024
Qarku Gjirokastrë (B. Gjirokastrë, B. Libohovë, B. Tepelenë, B. Memaliaj, B. Përmet, B. Këlcyrë, B. Dropull) (Transport publik)	A. Shumeli Z. Mujali B. Hoxha E. Mata E. Qerimaj	18.11.2024 - 21.11.2024 02.12.2024-13.12.2024
Qarku Vlorë (B. Vlorë, B. Sarandë, B. Delvinë, B. Finiq, B. Konispol, B. Himarë, B. Selenicë) (Automjeti i punës)	A. Basha A. Xhaxhiu A. Kabali F. Doksani	02.12.2024-13.12.2024

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

